



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.477/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit TEB Sh.a, me seli ne Prishtinë rr. “Agim Ramadani” nr.15, ndaj debitorëve “Metaj” NPM, me seli ne Prishtinë dhe E.M. nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokat D.O. nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur sipas ankesës së debitorit, te paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore ne Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.339/2014 datës 09.03.2017, me datë 05.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorëve Metaj NPM, me seli ne Prishtinë dhe E.M. nga Prishtina, kurse Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.339/2014 i datës 09.03.2017, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore ne Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.339/2014 dt.09.03.2017, ka Refuzuar si te pabazuar prapësimet e debitorëve Metaj NPM, me seli ne Prishtinë dhe E.M. nga Prishtina, te paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.034/14 datë 13.11.2014, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi kanë ushtruar ankesë debitorët përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak te shkaqeve nga neni 71 par.1.1 dhe 1.3 te LPP, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë aktvendimin e atakuar ta shfuqizoj dhe çështja të kthehet ne shkallë te parë ne rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori TEB Sh.a, me seli ne Prishtinë rr. “Agim Ramadani” nr.15, me datën 13.11.2014 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve Metaj NPM, me seli ne Prishtinë dhe E.M. nga Prishtina, në bazë të dokumentit përmbartues: Marrëveshja mbi Kredinë nr.28133 dt.29.03.2013, Marrëveshja mbi Pengun, Lista e Pengut, Konfirmim i regjistrimit R-20130416-134 nga data 16.04.2013 deri me 16.04.2016, i lëshuar nga Zyra për Regjistrim te Pengut pranë Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë. Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.034/14 dt.13.11.2014, ka lejuar përmbartimin për shumën e detyrimit te debitorëve ndaj kreditorit qe rrjedh nga marrëveshjet e sipër cekura, në vlerë totale prej 19,018.02 euro.

Kundër këtij urdhri, me datën 19.11.2014 dhe dt. 21.11.2014 debitorët përmes përfaqësuesit te tyre kanë ushtuar prapësim, me pretendimin se dokumenti ne bazë te cilit është marrë vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare te përmbartueshmërisë nga neni 71 par.1.1 te LPP. Më tej se palët janë pajtuar që të mos kërkojnë përmbartim ne bazë të dokumentit përmbartues për një periudhë kohore duke qenë se nga ana e debitorit nuk kontestohet borxhi përveç lartësisë se pretenduar, debitori ka dëshirë qe ta përmbushë borxhin ne bazë te një marrëveshje paraprake dt.28.10.2014 me kushte te reja te marrëveshjes se kredisë që do ti mundësohet debitorit gjë qe ka edhe bazë ligjore nga neni 335 te LMD dhe neni 200 pika 1 e LPP-së, dhe që në vend te përmbartimit te sendeve te paluajtshme objekt përmbartimi te jene te ardhurat mujore te debitorit. Shton se nga borxhi i deklaruar ne propozimin për përmbartim nuk është zbritur pagesa e bërë ne shumen prej 3,000.00 euro me dt.28.10.2014 që vërtetohet ne dëftesën për pagesë nr.00006606. Borxhi i kërkuar nga kreditori nuk është shuma si ne propozim për përmbartim por shuma prej 11,638.00 euro, andaj propozon qe gjykata ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor

Përgjigje ne prapësimin e debitorëve me datën 24.11.2014 ka paraqitur kreditori, me pretendimin se sipas marrëveshjeve debitorët kanë qenë te obliguar te përgjigjen për obligimet e tyre por pasi te njëjtit kane dështuar të kryejnë obligimet e tyre dhe janë ne vonesë edhe pas tentimeve të njëpasnjëshme të kreditorit për te arritur marrëveshje për kryerjen e obligimeve, debitorët kanë dështuar ti kryejnë këto obligime. Debitorët janë pajtuar qe ti bëjnë pagesat e rregullta dhe te plota sipas planit te pagesave, pagesat e bëra nga debitorët janë llogaritur dhe shuma e paguar është zbritur nga borxhi total, kërkesa për ti dhënë një afat shtesë debitorëve është vetëm për zvarritje te lëndës dhe përfitimit ne kohë. Kërkon nga përmbartuesi privat te vazhdoj me procedurën përmbartimore sepse nuk ka asnjë fakt apo rrethanë qe debitori ti mbështes pretendimet e tij ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorëve dhe te vazhdohet me procedurën e përmbartimit.

Gjykata Themelore ne Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimeve dhe përgjigjes ne prapësime, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.339/2014 dt.09.03.2017, me të cilin e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorve, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të

njëjtë. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka arsyetuar se ka analizuar pretendimet e debitorëve dhe ka gjetur se prapësimet e debitorëve nuk janë te bazuara, debitorët nuk kanë ofruar prova për te argumentuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP, gjykata ka vlerësuar se marrëveshja mbi kredinë nr. 28133 dt.29.03.2013, marrëveshja mbi mbitërheqjen mundësuar dt.29.03.2013, lista e pengut nr.28133, ne bazë të cilave përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin janë dokumente përmbaruese dhe përbejnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore te parapara me nenin 21 dhe 22 par.1 dhe nen par 1.7 të LPP, janë dokumente përmbarimore dhe përbejnë bazë juridiken për caktimin e përmbarimit sepse i kanë plotësuar kushtet ligjore te parapara edhe nga neni 27 të LPP, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarimin sipas dokumentit të përmbarimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, dhe në prapësimet e debitorëve nuk janë paraqitur asnjë nga shkaqet të cilat janë parapara në nenin 71 të LPP-së, që do të pengonin përmbarimin e lejuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë, bazuar ne shkresat e lëndës vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar se marrëveshjet mbi bazën e te cilave është mbështetur propozimi për përmbarim e saktësisht Marrëveshja mbi Kredinë nr.28133 dt.29.03.2013, Marrëveshja mbi Pengun, Lista e Pengut Konfirmim i regjistrimit R-20130416-134 nga data 16.04.2013 deri me 16.04.2016, i lëshuar nga Zyra për Regjistrim te Pengut pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë e te cilat marrëveshje i kanë nënshkruar të dyja palët, janë dokumente përmbarimore dhe paraqesin titull ekzekutiv, pra ashtu siç parasheh neni 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, si edhe Marrëveshja mbi Pengun e cila po ashtu është e rregulluar me dispozita ligjore dhe atë sipas nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, i cili shprehimisht përcakton: *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas nën-paragrafit 1.7, shtohet nën-paragrafi ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut*”, me çka janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbarimit dhe në të njëjtën

kohë edhe për refuzimin e prapësimeve. Andaj bazuar ne këto arsye kjo gjykatë vlerësoi se pretendimi i debitorëve se dokumenti ne bazë te cilit është marrë vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare te përmbarueshmërisë nga neni 71 par.1.1 te LPP nuk qëndron dhe është i pabazuar, ndërsa sa i përket pretendimeve tjera te debitorëve kjo gjykatë vlerësoi se te njëjtat rezultojnë si te pathemelta dhe te paargumentuara me prova konkrete ashtu siç parasheh nenin 69 par.4 i LPP, ashtu qe i refuzoi si te pabazuara, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoj.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore sipas parimit te rigorozitetit formal bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.477/22, me datë 05.02.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha